



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

- Sektori i Kuvendit-

01Nr. 60/01-36366/2021
Kaçanik, 08.12.2021

PROCESVERBAL

Nga mbledhja Inauguruese (Konstituive) e Kuvendit të Komunës (KK) Kaçanik, mbajtur më 08 Dhjetor 2021.

Mbledhja u mbajt në katin e III (Tretë) të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës;

- 27 Anëtarë e zgjedhur të Kuvendit të Komunës,
- Kryetari i zgjedhur i komunës, Besim Ilazi,
- Nënkryetari aktual i komunës dhe drejtorët aktual të drejtorive komunale,
- Zyrtarë komunal,
- Përfaqësuesi nga OSBE-së, Gazmend Murseli,
- Përfaqësues nga shoqëria civile (OJQ)- mediat dhe përfaqësues tjerë,
- Qytetarë të komunës.

Mbledhja monitorohet nga MAPL, përmes Tel prezencës, nga Vjosa Ahmetaj.

Fillimisht të gjithë anëtarët e zgjedhur të KK fillimisht e nënshkruan listën e pjesëmarrjes në mbledhje të KK (ashtu siç është paraparë në pikën 1 të rendit të punës).

Mbledhjen e hapi Kryetari i zgjedhur i Komunës, Besim Ilazi, i cili iu drejtua të pranishmëve me këto fjalë:

Zonja dhe Zotërinj, të nderuar anëtarë të zgjedhur të Kuvendit të Komunës Kaçanik, Mirë së keni ardhur në mbledhjen Inauguruese të Kuvendit të Komunës, data 08 Dhjetor 2021.

Fillimisht iu njoftoj se në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Pushtetit Lokal, e kam ftuar mbledhjen Inauguruese të Kuvendit të Komunës.

Më këtë rast e shfrytëzoj rastin t'i përshëndes anëtarët e zgjedhur të kuvendit të komunës që kanë fituar ulëse në Kuvendin e Komunës si rezultat i zgjedhjeve komunale të datës 17 Tetor 2021.

Iu uroj shëndet, punë të mbarë dhe suksese në mandatin e zgjedhur 4 vjeçar.

Gjithashtu shfrytëzoj rastin t'i përshëndes; përfaqësuesit e strukturave ndërkombëtare, zyrtarët e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ish kryesuesin e kuvendit, anëtarët e ekzekutivit të komunës (nënkryetarin e komunës dhe drejtorët e drejtorive), qytetarët e komunës së Kaçanikut, mediat, përfaqësuesit e shoqërive civile dhe të pranishmit tjerë.

Në këtë mbledhje do të bëhet Inaugurimi i dy organeve me të larta të Komunës së Kaçanikut;

1. Kuvendit të Komunës – organit me të lartë legjislativ të komunës, dhe
2. Kryetarit të Komunës, organit më të lartë ekzekutiv të komunës.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, mbledhjen Inauguruese të Kuvendit të Komunës e udhëheq anëtari më i vjetër i kuvendit, deri më zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit.

Në bazë të datëlindjeve të cilët me ofruan nga Zyra e KK, u konstatua se anëtari më i vjetër i kuvendit është, Kadri Krivenjeva.

Ftojme z. Kadri Krivenjeva që të udhëheq më mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

3. Fjala mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të kuvendit të komunës;

Kryesuesi i mbledhjes, Kadri Krivenjava, E Falënderoj Kryetarin e Komunës, z. Besim Ilazi që ma dha fjalën për të udhëhequr me mbledhjen e kuvendit.

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje, e në veçanti i përshëndes anëtarët e zgjedhur të Kuvendit të Komunës që kanë fituar ulëse në kuvend.

Njëherë shfrytëzoj rastin të përshëndes, Kryetarin e zgjedhur të Komunës së Kaçanikut, z. Besim Ilazin, që ka fituar në zgjedhjet lokale të 17 tetor 2021 respektivisht në rundin e dytë të votimit me 14 Nëntor 2021, për të udhëhequr me Komunën e Kaçanikut. Për këtë takim është propozuar ky:

Rend Pune

1. Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës;
2. Fjala mirëseardhëse e Kryetarit të Komunës (të zgjedhur);
3. Fjala mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës;
4. Dhënia e Betimit Solemn e anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës;
5. Dhënia e Betimit Solemn e Kryetarit të zgjedhur të Komunës, Besim Ilazi;
6. Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës;
7. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës;
8. Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës; dhe
9. Mbyllja e mbledhjes.

Kuorumi ekziston për të u mbajtur mbledhja, Procesverbalin e mbledhjes do ta mbajë zyrtarja e kuvendit, znj. Makfire Malsiu.

Fillojmë më rendin e punës;

Pikët; 1, 2 dhe 3 u përfunduan, atëherë kalojmë në pikën e katërt.

4. Dhënia e Betimit solemn e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Fletë-betimet u janë shpërndarë të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së bashku më Ftesën për mbledhje, kështu që nëse jeni të pajtimit shkojmë me ceremoninë e betimit të anëtarëve të kuvendit.

Para se të fillojmë me ceremoninë e betimit, u njoftoj se anëtarët e kuvendit të komunës të cilët nuk e japin dhe nënshkruajnë betimin solemn brenda afatit 1 muaj ditë nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve, pushojnë të jenë anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Më këtë rast, i ftoj të gjithë pjesëmarrësit e kësaj mbledhje që në shenjë respekti për betimin e anëtarëve të kuvendit të komunës, të ngritën në këmbë, ndërkaq të gjithë anëtarët e zgjedhur të kuvendit të komunës, që mendojnë të marrin përsipër detyrën e anëtarit të kuvendit të lexojnë tekstin e "Betimit Solemn" të përcaktuar si në nenin 35.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Unë do ta lexoj tekstin e betimit, ndërkaq ju e përsërisni çdo fjalë që unë e lexoj.

"Betohe (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e më ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të komunës së Kaçanikut, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë. Betohe.

Tani kërkoj nga anëtarët e Kuvendit të Komunës të nënshkruajnë Flet-betimin, ndërkaq në fund i dorëzoni të Sekretaria e kuvendit. Pasi u dha betimi dhe u nënshkruan deklaratat solemne, Kryesuesi i mbledhjes konstaton se u,

INAUGURUA (KONSTITUUA)

Kuvendi i Komunës Kaçanik,- organi më i lartë legjislativ i komunës, i dalë nga Zgjedhjet lokale të datës 17 Tetorit 2021.

Kuvendi i Komunës Kaçanik- Organi më i lartë i komunës, i përfaqësuar nga 27 anëtarët e zgjedhur që fituan ulëse në kuvend, si rezultat i Zgjedhjeve lokale të datës 17 Tetor 2021, të cilët e dhanë betimin dhe e nënshkruan deklaratën solemne në këtë mbledhje, është si në listë:

1	2	3
Nr. Rend.	Emri dhe Mbiemri	Përkatësia Politike
01.	Brahim Imishti	PDK
02.	Kemal Murseli	PDK
03.	Hamide Luma	PDK
04.	Kadri Krivenjeva	PDK
05.	Fitore Vishi	PDK
06.	Rrustem Zenuni	PDK
07.	Edon Baftiu	PDK
08.	Selajdin Troni	PDK
09.	Fatmir Bunjaku	PDK
10.	Bashkim Krasniqi	PDK
11.	Florina Lika-Vishi	PDK
12.	Lejla Muhaxheri-Çaka	PDK
13.	Agim Mani	LVV
14.	Kadrije Lika-Troni	LVV

15.	Adnan Reka	LVV
16.	Naim Beça	LVV
17.	Raif Kasa	LVV
18.	Ernesta Krasniqi	LVV
19.	Bashkim Luma	LVV
20.	Arta Avdiu	LVV
21.	Ardita Rrahmani	LDK
22.	Besnik Salihu	LDK
23.	Betim Shala	LDK
24.	Arlinda Rakoci-Raka	LDK
25.	Hafize Sallahi	AAK
26.	Ekrem Livoreka	AAK
27.	Agim Çaka	NISMA

Lista është sipas numrit të votave të secilit subjekt politik, me përjashtim të anëtarit të listuar me Nr. 1 Brahim Imishti, i cili me Vendim të KQZ Nr. 3335-2021 të datës 07.12.2021 është emëruar për të zëvendësuar kandidatin e zgjedhur për anëtar të KK, Besim Ilazi, i cili ka ofruar dorëheqje nga kjo pozitë, për shkak të zgjedhjes së tij Kryetar Komunes së Kaçanikut.

Subjektet Politike të Përfaqësuar në Kuvend janë:

- | | |
|---|--------------------|
| 1. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) | 12 mandate; |
| 2. Lëvizja Vetëvendosje (LVV) | 8 mandate; |
| 3. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) | 4 mandate; |
| 2. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) | 2 mandate; |
| 5. Nisma Socialdemokrate (NISMA) | 1 mandat. |

Në vazhdim Kryesuesi i mbledhjes Kadri Krivenjeva, ua bëri më dije anëtarëve të zgjedhur të kuvendit, se më dhënien e betimit dhe nënshkrimit të deklaratës solemne, të gjithë Anëtarët e zgjedhur të Kuvendit të Komunës, nga sot, data 08 Dhjetor 2021, i marrin zyrtarisht detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe aktet tjera nënligjore, të anëtarit të kuvendit të KK për mandatin e tyre të zgjedhur 4 vjeçar. Urime anëtarëve të zgjedhur të KK, shëndet dhe suksese.

5. Dhënia e Betimit të kryetarit të zgjedhur të Komunës, Besim Ilazi,

Kryesuesi i mbledhjes, Kadri Krivenjeva, E ftoj Kryetarin e zgjedhur të Komunës së Kaçanikut, z. Besim Ilazi, i cili i ka fituar zgjedhjet lokale të datës 17 Tetor 2021 respektivisht në Rundin e dytë të votimit të datës 14 Nëntor 2021, të ngritët në këmbë dhe para Kuvendit të Komunës të e lexoj tekstin e Betimit Solemn të përcaktuar si në nenin 57 të Rregulloren për Vetëqeverisjen Lokale. Ndërkaq në shenjë respekti për betimin e Kryetarit të Komunës, i ftoj të gjithë të pranishmit të ngritën në këmbë.

Kryetari i zgjedhur i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi e lexoj Tekstin e Betimit Solemn për Kryetar Komune si vijon:

Betohem(ose deklaroj solemnisht) që do t'i kryej detyrat e mia dhe do të i ushtroj kompetencat e mia si kryetar i komunës së Kaçanikut me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim më ligjin, në mënyrë që të siguroj kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Pas leximit të tekstit të betimit, Kryesuesi i mbledhjes, kërkoj nga Kryetari i Komunës që ta nënshkruaj Fletë- betimin, dhe i njëjti në fund i dorëzohet Sekretarisë së kuvendit. Më këtë rast, Konstatohet se u,

INAUGURUA (KONSTITUUA)

Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, - organi më i lartë Ekzekutiv i Komunës, dhe nga kjo datë Kryetari i zgjedhur i Komunës e merr zyrtarisht detyrën për të udhëhequr me Komunën e Kaçanikut konform rregullativave ligjore.

Kjo pikë konstatohet se përfundoj më kaq, ndërkaq kryetarit të zgjedhur të komunës z. Besim Ilazi i urojmë shëndet, suksese, punë të mbarë në mandatin e tij të zgjedhur, 4 vjeçar, për të udhëhequr më Komunën e Kaçanikut.

Kalojmë në pikën e 6:

6. Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës, Besim Ilazi;

E ftojë Kryetarin e zgjedhur të Komunës, Besim Ilazi, që para të pranishmëve të mbajë një fjalë përshëndetëse.

Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës, Besim Ilazi, Të nderuara familje të dëshmorëve dhe martirëve, të nderuar veteranë, invalidë të UÇK, i nderuari ish kryesues i KK, të nderuar asambleistë; Me lejoni që fjalën time ta filloj me duke iu uruar marrjen e mandatit të ri të këshilltarit komunal, e që besoj se jeni të zotuar për përcjellje të mesazhit të qytetarëve dhe shqetësimet e qytetarëve për të realizuar atë për të cilën jemi betuar e zotuar para qytetarëve. Të nderuar përfaqësues të mediave, përfaqësues të OSBE-së, qytetarë të nderuar, zyrtarë dhe ju të pranishmit tjerë; Sot është një ditë e veçantë për mua, ngase sot po e marrë për herë të 4 mandatin nga qytetarët e komunës të cilët na besuan gjatë punës sonë qeverisëse. Andaj sot ky nder dhe privilegj që na e dhanë qytetarët është një përgjegjësi dhe obligim shtesë për mua – ekzekutivin e komunës për 4 vitet e ardhme. Nuk mund të mos i falënderoj edhe asambleistat e legjislaturës së kaluar për bashkëpunimin e mirëfilltë e sidomos në realizimin dhe shtyrjen përpara të projekteve të cilat kanë qenë në interes të qytetarëve të komunës. Sot kur jam para qytetarëve të komunës dhe zotohem se me nderë dhe përpikëri do të mundohem t'i realizojmë ato zotime të cilat i kemi dhënë gjatë fushatës. Të njëjtën kohë dua të falënderoj edhe oponentët e mi politik për qasjen e tyre konstruktive e në veçanti gjatë fushatës zgjedhore të cilat i realizuam bashkërisht, por të njëjtën kohë dua të falënderoj edhe për alternativat ata që kanë ofruar, e që besoj që bashkërisht për gjatë mandatit 4 vjeçar do t'i realizojmë. Të njëjtën kohë i falënderoj edhe anëtarët e ekzekutivit 4 vjeçar me të cilët bëmë një punë të jashtëzakonshme dhe shpresojmë se do të vazhdojmë me ekzekutivin e ri në mandatin 4 vjeçar. Të njëjtën kohë dua të falënderoj edhe partnerin tim të koalicionit së bashku me Ylber Bajra dhe drejtorin e atij koalicionin, të cilët bashkërisht u munduam për 4 vite të jemi karshi kërkesave të qytetarëve për të bërë me të mirën e mundshme për qytetarët e vendit tim, po të njëjtën kohë, sot zotohem edhe një herë se mandati im qeverisëse do të jetë me dinamik, për të vetmen arsye, ndoshta përvojës së krijuar, në të njëjtën kohë zotohem se në përpikëri do realizojmë atë që e kam synim, duke respektuar ligjin. Të njëjtën kohë do të mundohem që të jem afër qytetarëve të komunës tonë, sidomos gjatë shqetësimeve të tyre. Të njëjtën kohë iu bëjë thirrje qytetarëve të komunës së Kaçanikut sidomos në raste të vendimmarrjes, ku mendojmë se pa vendimmarrje të qytetarëve të komunës besoj se do të jemi të mangët në realizimin e kërkesave të cilat vazhdimisht do

të dalin para nesh. Andaj edhe njëherë duke i falënderuar të gjithë qytetarët e Kaçanikut për një mbështetje, sot me keni bërë krenar, por megjithatë me keni dhënë edhe një përgjegjësi shtesë për realizimin e synimeve tona të përbashkëta. Andaj mendojmë që komuna e Kaçanikut është komuna jonë e përbashkët, edhe një herë i ftoj qytetarët e Kaçanikut, asambeistët për një bashkëpunim të përbashkët që të bëjmë me të mirën e mundshme për qytetarët e komunës tonë. Ju faleminderit.

Kryesuesi i mbledhjes, Faleminderit Kryetar i Komunës, Besim Ilazi, atëherë kalojmë në pikën e 7;

7. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës;

Fillimisht, Kryesuesi i mbledhjes, Kadri Krivenjeva e njoftoj Kuvendin e Komunës në lidhje me procedurat për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit.

Ju njoftoj se procedura për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit është e rregulluar më Udhëzimin Administrativ 2009/1 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Udhëzimin Administrativ e keni marrë nga Sekretaria e KK.

Sipas nenit 2.2 të këtij Udhëzimi, secili subjekt politik, nismë qytetarësh apo kandidat i pavarur i përfaqësuar në kuvend ka të drejtë që nga radhët e anëtarëve të kuvendit të propozoj një anëtar për Kryesues të Kuvendit të Komunës. Fillimisht kuvendi duhet të formoj një komision për mbarëvajtjen e procesit të votimit.

Nëse nuk ka kush diçka rreth kësaj çështje, atëherë shkojmë më formim të komisionit, A ka kush ndonjë propozim konkret për përbërjen e komisionit, nëse ka atëherë shkojmë me përbërje të komisionit prej 3 anëtarëve. Kërkoj nga 3 subjektet politike me të mëdha të japin propozimet për nga 1 anëtarë të komisionit.

Për anëtarë të komisionit u propozuan:

Nga PDK Kemal Murseli, e propozoj për anëtar të komisionit z. Rrustem Zenuni.

Nga LVV Agim Mani, e propozoj për anëtare të komisionit, znj. Ernesta Krasniqi.

Nga LDK, Besnik Salihu e propozoj për anëtare të komisionit znj. Arlinda Rakoci Raka.

Kryesuesi i mbledhjes, Propozimet e dala i shtroj në votim dhe u aprovuan njëzëri. Në sajë të rezultatit të votimit, konstatoj se Kuvendi i Komunës, mori;

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të komunës në përbërje:

- 1. Rrustem Zenuni nga PDK;**
- 2. Ernesta Krasniqi nga LVV; dhe**
- 3. Arlinda Rakoci-Raka nga LDK.**

Në vazhdim kryesuesi i mbledhjes, Kadri Krivenjeva, jep sqarime te nevojshme për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës;

Fillimisht ju njoftoj se Kryesuesi i Kuvendit zgjidhet për mandat të njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës- 4 vjeçar. Për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, iu njoftoj Votimi bëhet më vota të fshehta, ndërkaq zhvillohen 3 runde të votimit:

Për të u zgjedhur në rundin e parë të votimit, kandidati duhet të merr më tepër se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të kuvendit, apo 14 votë Për.

Nëse në rundin e parë të votimit, asnjëri kandidat nuk e ka fituar më tepër se gjysmën e votave, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të kuvendit, atëherë dy kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave shkojnë në rundin e dytë të votimit.

Në rundin e dytë të votimit, për kryesues kuvendi mund të zgjidhet kandidati që ka fituar më tepër se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të kuvendit.

Nëse asnjëri nga dy kandidatët nuk ka fituar numrin e mjaftueshëm të votave në rundin e dytë të votimit për të u zgjedhur për kryesues të kuvendit, atëherë shkohet më rundin e tretë. Në rundin e tretë të votimit, Kryesues i Kuvendit të Komunës zgjidhet kandidati i cili merr më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë.

Nëse jeni të pajtimit, shkojmë më propozime konkrete për kryesues të kuvendit.

Më këtë rast ftojmë subjektet politike që të dalin më propozim konkret, fillojmë me propozime duke filluar nga partia më e madhe, PDK-a, e kështu me radhë.

Propozimet për Kryesues të Kuvendit:

znj. Fitore Vishi, Të nderuar anëtarë të KK, të nderuar të pranishëm, ne si Parti Demokratike e Kosovës, e propozojmë Kemal Murseli për Kryesues të Kuvendit të Komunës. Arsyeja pse e zgjedhim këtë kandidat, është përvoja e tij politike që e posedon, gjithashtu është asamleisti më i votuari nga PDK.

Kryesuesi i mbledhjes Kadri Krivenjeva, Faleminderit Fitore, atëherë kërkoj nga LVV nëse kanë ndonjë propozim;

z. Agim Mani, Nga LVV nuk kemi kandidat për Kryesues të KK.

znj. Ardita Rrahmani, Faleminderit kryesues, Nga LDK nuk kemi kandidat për Kryesues të KK.

znj. Hafize Sallahi, Përshëndetje për të gjithë, Së pari kisha dashur me e uruar Kryetarin e Komunës për mandatin e fituar, gjithashtu ju uroj edhe anëtarëve të zgjedhur të KK për mandatin e fituar, duke iu dëshiruar punë të mbarë për mandatin 4 vjeçar. Nga AAK e propozojmë Ekrem Livoreka për Kryesues të KK.

Kryesuesi i mbledhjes, faleminderit znj. Hafize, atëherë nga NISMA a ka kandidat.

z. Agim Çaka, Nga NISMA nuk ka kandidat për Kryesues të KK.

Kryesuesi i mbledhjes Kadri Krivenjeva, Meqenëse u propozuan dy kandidatë për Kryesues të Kuvendit:

1. Kemal Murseli nga Partia Demokratike e Kosovës-PDK; dhe

2. Ekrem Livoreka nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës- AAK

Atëherë kërkojmë nga komisioni i formuar të filloj më udhëheqjen e procedurave zgjedhore. Procedurën e votimit e kryen komisioni i zgjedhur, deri në dhënien e rezultatit përfundimtar. Kutia e votimit dhe kabina janë siguruar për votim. Fletë-votimet do të përgatiten nga komisioni në bashkëpunim me zyrtaren e kuvendit.

Komisionit për zbatimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesuesit filloj me punën e vet ku u përgatitën fletëvotimet në bashkëpunim me zyrën e KK. Anëtarët e KK u thirrën emër për emër nga anëtari i komisionit, Rustem Zenuni për me votuar sipas regjistrat, ku secili anëtar paraprakisht e nënshkroi në regjistër, pastaj e mori fletëvotimin e vulosur nga Ernesta Krasniqi, ndërkaq të kutia e votimit qëndroj Arlinda Rakoci Raka. Nga 27 anëtarë më të drejtë vote, 4 anëtarët nga LDK, Ardita Rrahmani, Besnik Salihu, Betim Shala dhe Arlinda Rakoci-Raka secili në emër të vet deklaruan se nuk marrin pjesë në votim

Pas përfundimit të procedurës së votimit, komisioni filloj me numërimin e votave. Numërimi u bë para anëtarëve të KK duke fokusuar secilin fletëvotim para anëtarëve të KK për shkak të transparencës. Në fund komisioni hartoj procesverbalin i cili proces pas nënshkrimit nga anëtarët e komisionit, u lexua nga anëtari, Rustem Zenuni. Sipas Raportit të komisionit, në Rundin e parë të votimit, numri i anëtarëve me të drejtë vote është 27 anëtarë. Në votim kanë marrë pjesë: 23 anëtarë.

Vota të vlefshme, 15

Vota të pavlefshme, 08

Kandidatët e propozuar kanë marrë këtë numër të votave:

1. Kemal Murseli nga Partia Demokratike e Kosovës –PDK, ka marrë gjithsej 14 votë.

2. Ekrem Livoreka nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK ka marrë 1 votë. Raporti i nënshkruar nga komisioni iu dërgua Kryesuesit të mbledhjes Kadri Krivenjeva së bashku me fletëvotimet.

Kryesuesi i mbledhjes- Kadri Krivenjeva E lexoj procesverbalin e komisionit si vijon: Zgjedhjet për Kryesues të Kuvendit të Komunës janë mbajtur në katin e III të objektit të komunës në sallën e KK. Numri i anëtarëve me të drejtë vote është 27.

Në votim - në rundin e parë të votimit kanë marrë pjesë 23 anëtarë. Vota të vlefshme janë 15, vota të pavlefshme janë 8.

Në bazë të raportit të komisionit, konstatohet së, Në rundin e parë të votimit, kandidati me Nr. 1 Kemal Murseli nga Partia Demokratike e Kosovës-PDK, ka marrë 14 votë Për, ndërkaq kandidati nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës- AAK, Ekrem Livoreka ka marrë 1 votë.

Nga rezultati i votimit të rundit të parë, kandidati me Nr. 1, Kemal Murseli nga Partia Demokratike e Kosovës-PDK, shihet së ka marrë numër të mjaftueshëm të votave konform Udhëzimit Administrativ për me u zgjedhur Kryesues i Kuvendit të Komunës. Andaj mbi bazën e këtij rezultati të votimit të fshehtë që u zhvillu për zgjedhjen e kryesuesit të KK, del konstatimi se, Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për zgjedhjen e Kemal Murseli nga Partia Demokratike e Kosovës-PDK, Kryesues i Kuvendit të Komunës Kaçanik.

Mandati i Kryesuesit të KK është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës- 4 vjeçar.

Kalojmë në pikën e 8;

8. Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,

Kryesuesi i mbledhjes, Kadri Krivenjeva, E ftoj Kryesuesin e zgjedhur i Kuvendit të Komunës, Kemal Murseli të udhëheq me pikët 8 dhe 9 të mbledhjes.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, Faleminderit Kryesues i mbledhjes, përshëndetje anëtarët e zgjedhur të komunës që kanë fituar ulëse në kuvend, Kryetarin e Komunës, Besim Ilazi, iu uroj për mandatin e fituar për me udhëhequr me Komunën e Kaçanikut, ndërkaq i përshëndeti përfaqësuesit e strukturave ndërkombëtare e vendore që po e monitorojnë punën e kuvendeve komunale, zyrtarët e MAPL të cilët e monitorojnë punën e KK, përfaqësues të OJQ dhe të pranishmit tjerë. Përshëndetje familjes time e cila çdo herë është e pranishme në çdo rrethanë, është motiv kryesor i punës time. Një përshëndetje e veçantë shkon për qytetarët e Komunës së Kaçanikut të cilët përmes procesit demokratik iu drejtuan kutive të votimit, që na besuan dhe vlerësuan që t'i përfaqësojmë interesat e tyre në organin më të lartë të Kuvendit të Komunës, me votën e të cilëve jemi këtu që na besuan dhe vlerësuan të jemi këtu, I falënderoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që ma dhanë besimin për të kryesuar Kuvendin e Komunës-organin më të lartë të komunës.

Gjatë mandatit tim ju premtoj se do t'i udhëheq punët e kuvendit në mënyrë të drejtë dhe me përgjegjësi të lartë morale e politike, duke marrë bashkërisht vendime të ligjshme në të mirë të qytetarëve të komunës tonë. Qytetarët e komunës tonë e meritojnë që ne të bëjmë me të mirën e mundshme për ta, sepse vendi dhe populli i jonë ndër breza sakrifikoj shumë që ata sot të jetojnë të lirë dhe të udhëhiqen nga bijtë dhe bijat e tyre të zgjedhur me votën e lirë. Motivi kryesor i punës tonë, do të jetë e kaluara e lavdishme,

lufta e UÇK dhe e popullit tonë, gjaku i derdhur i dëshmorëve, heronjve dhe martirëve, të cilët e dhanë jetën që sot ne të jetojmë të lirë.

Gjatë punës time në këtë mandat, do të jem konstruktiv ndaj opozitës dhe pres që edhe opozita të jep kontributin e vet në mënyrë konstruktive për interesa të qytetarëve të komunës, në të mirë të zhvillimit të komunës. Nga ky kuvend kërkoj të jemi në nivel të përgjegjësive që i kemi marrë, për një mbarëvajtje të mirë të punës së këtij kuvendi, kështu se bashku me ju, kryetarin e komunës dhe mekanizmat tjerë relevantë do të angazhohemi t'i qojmë proceset përpara. Faleminderit.

Kalojmë në pikën e 9;

9. Mbyllja e Mbledhjes

Para se ta mbyll mbledhjen, Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli i njoftoj anëtarët e KK së duhet ta deklaroni gjendjen e pasurisë në Agjencionin Antikorrupsion. Ky është obligim i juaj personal ashtu që formularët e plotësuar t'i dërgoni personalisht në Agjencion apo përmes email adresave tuaja. Sipas Ligjit Nr. 04,L-050 për Deklarim, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë, afati ligjor për deklarimin e pasurisë është 30 ditë nga data e marrjes së detyrës zyrtare, për ata të cilët e kanë marrë mandatin, me përjashtim të anëtarëve të cilët janë rizgjedhur të cilët e bëjnë deklarimin e rregullt vjetor nga 01-31 mars. Meqenëse shumica e anëtarëve janë për herë të parë në kuvend, të gjithë anëtarëve të zgjedhur të KK iu kemi dërguar, formularët e gjendjes së pasurisë, kështu mos e harroni me deklaruar pasurinë në afatin e përcaktuar ligjor, në mënyrë që mos të përballeni me procedura gjyqësore. Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu që e konstatoj mbledhjen të përfunduar.

Paraprakisht iu njoftoj së do të bëjmë homazhe të Varrezave të Dëshmorëve, pastaj me anëtarët e KK do të kemi një drekë solemne të restorant "Mani". Faleminderit, shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja i përfundoj punimet në ora: 12: 05

Procesmbajtës:

Makfire Malsiu

Makfire Malsiu

Kryesuesit e mbledhjes:

1. Besim Ilazi
2. Kadri Krivenjeva
3. Kemal Murseli

